



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 445/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nenad Lazic dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Uran Limani nga Prishtina, paraqitur kundër Egzon Azemi Kryesues i Vendvotimit në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Uran Limani në Prishtinë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.11.2013, nga Uran Limani, në Prishtinë në të cilën thekson se, nuk i është lejuar të votoj sepse kryesuesi supozon që ka pasur pika të solucionit në pjesën e epërme të dorës së majtë, ku thotë se gishtat e dy duarve nuk kanë gjurmë të lëngut si dhe këto pika që po vërehen në pjesën e epërme të dorës janë reaksion kimik i disa njollave të cilat i shfaqen në duar ose ndonjë kontakt i mëhershëm me votuesit e tjerë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet e ankuesit në ankesën e tij se nuk i është lejuar të votoj sepse kryesuesi supozon që ka pasur pika të solucionit në pjesën e epërme të dorës së majtë ku thotë se gishtat e dy duarve nuk kanë gjurmë të lëngut si dhe këto pika që po vërehen në pjesën e epërme të dorës janë reaksion kimik i disa njollave të cilat i shfaqen në duar ose ndonjë kontakt i mëhershëm me votuesit e tjerë.

PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullores së PZAP-I lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 445/2013 më datën 06.11.2013

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha

Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*

